

VENDIM
Nr. 125, datë 4.6.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AED SOLAR” SHPK, NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK
TOPOJË, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1998 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1 germa “a” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë “AED SOLAR” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 KW,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 3 prot., datë 1.2.2018, shoqëria “AED Solar” sh.p.k., paraqiti në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 kw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 54, datë 7.3.2018, ka vendosur për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AED SOLAR” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë me kapacitet prodhues 1998 KW për shkak të mangësive në dokumentacionin e depozituar.

- Me shkresën me nr. 5 prot., datë 30.3.2018 dhe protokolluar në ERE me nr. 148/3, datë 3.4.2018, shoqëria “AED SOLAR” sh.p.k., ka riaplikuar në ERE për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 KW.

- Në bazë të nenit 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se: “Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6 të këtij neni brenda 1 muaji nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.”

- Sa më sipër, rezulton se aplikimi i shoqërisë ka ardhur brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

- Në vijim bordi i ERE-s, me vendimin nr. 88, datë 20.4.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AED SOLAR” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centralit Fotovoltaik Topojë, Fier me kapacitet të instaluar 1998 kw.

- Me shkresën nr. 55/21 datë 24.4.2018, është bërë njoftimi në media, lidhur me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “AED Solar” sh.p.k., në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga centrali fotovoltaik dhe mbas përfundimit të afatit të paraqitjes së objeksioneve ose ankesave, nuk rezulton të jetë paraqitur në ERE, ankesë ose objeksion nga subjekte ose persona fizikë mbi këtë aplikim.

- Shoqëria “AED SOLAR” sh.p.k. ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kontratën me nr. 2608 rep. dhe nr. 1227/3 kol, datë 17.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik Topojë” me kapacitet prodhues 1998 kw, në Bashkinë Fier, qarku Fier, bazuar në nenin 25 të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015.

- Aplikimi i shoqërisë “AED SOLAR” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen

e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4, 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “AED SOLAR” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë me kapacitet të instaluar 1998 kw, për një afat 20-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti